



UNICEF
SHQIPËRI

PROJEKTI CLEEN – FLETORJA E NXËNËSIT


KLASA E DYTË

Pergatitur nga: Raiha Idrees

Emri im është _____

**Une dua qe Shqiperia ime te jete e bukur dhe
e paster**

UJI



**PËRDORENI
UJIN
ME KUJDES**

Tema: Uji

Aktiviteti # : Një

Aktiviteti: Përdorimi i ujit

Materialet: Laps e letër

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit



Grumbullimi i ujit në Shqipëri. Nga del uji? Pse e mbledh ujin në këtë mënyrë ky djalë? Përse do ta përdorë? Si ju duket ky ujë juve? A mund të përdoret për t'u pirë?



C'ndodh në këtë foto?
Si mblidhet uji?
Përse do të
përdoret?



Fëmijë që luajnë me ujë. Ky grup fëmijësh po kënaqet duke u freskuar në ujë. Kush e hedh ujin? Cfarë ndjesie të krijon lagia me ujë? Ku janë këta fëmijë?



Vajza që shkojnë për të mbushur ujë. Ku mendoni se gjendet burimi i ujit? Si ju vjen juve uji në shtëpi? Si mendoni ju se është jeta e këtyre dy vajzave? Sa shpesh shkojnë ato për ujë? A e kanë të vështirë të gjejnë ujë?

Tema: Format e Ujit

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Të presim e të ngjisim pamje që tregojnë ujin në forma të ndryshme

Materialet: Revista që janë për t'u hedhur, gërshërë, ngjitëse

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Keni mësuar se uji ka forma të ndryshme. A mund të gjeni pamje që tregojnë format e ndryshme të ujit: e ngurtë, e lëngshme dhe e gaztë? Pritini pamjet që do të gjeni, ngjitini më poshtë dhe shkruani çfarë forme ka uji në secilën prej tyre.

Tema: Uji

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të matim ujin e shiut

Materialet: Enë plastike, vizore dhe shënjues (lapustilë)

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

1. Gjeni një enë plastike.
2. Një një fletë letre, me anë të vizores bëni një matëse në centimetra.
3. Ngjiteni matësen e centimetrave tek ena.
4. Kur të bjerë shi, nxirreni enën në një vend të hapur.
5. Prisni 15 minuta dhe merreni enën.
6. Sa ujë është mbledhur në enë?
7. Është mbushur plot, përgjysëm apo është thujse bosh?
8. Ç'ngjyrë ka uji?
9. Është i pastër apo i ndotur?
10. Çfarë do të bëni me këtë ujë?
11. Vizatojeni enën. A mund ta vizatoni edhe sasinë e ujit që keni mbledhur?
12. Nëse java do të jetë me shi, mblidheni ujin përditë dhe bëni një grafik si më poshtë:

Ditët e javës	Uji i mbledhur në cm
E hënë	5 cm
E martë	
E mërkurë	
E enjte	
E premte	
E shtunë	
E dielë	


Tema: Ruajtja e Ujit

Aktiviteti # : Katër

Aktiviteti: Të bëjmë dhe të vendosim shenjat për kursimin e ujit në shkollë dhe në shtëpi

Materialet: Spango, lapsa me ngjyra, shënjes, gërshërë, shirit ngjites.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi



**Kurseni
Ujin**

Tema: Uji

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të bëjmë një digë

Materialet: Enë plastike e tejdukshme, e gjatë dhe e cekët, rërë, guralecë (si zhavorr akvariumi), ngjitëse në formë çamçakizi, kovë të mbushur me ujë

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

1. Këtë aktivitet mund ta bëni me vëllanë dhe motrën më të madhe
2. Mbusheni enën me rërë.
3. Bëni shtratin e një lumi në rërë.
4. Zgjidhni një pikë për të ndërtuar digën.
5. Përdorni ngjitëset si çamçakiz për të bërë digën duke lënë të rrjedhë vetëm pak ujë, por jo shumë. Mos harroni sesa më i thellë uji, aq më i madh presioni që ushtrohet në faqet e digës. Pra, baza e digës do të mbajë më shumë presion sesa maja e saj. Nëse digës i jepni formën e një trekëndëshi, baza do të jetë e gjerë dhe do të mund të mbajë më shumë presion.
6. Provojeni digën duke hedhur ujë nga kova në shtratin e lumit.
7. Si funksionoi diga? A ju duhet të ndreqni ndonjë gabim të mundshëm pas provës që bëtë?

Tema: Uji

Aktiviteti #: Gjashtë

Aktiviteti: Këngë për ujin

Materialet: Fjalët e këngës dhe instrumenta muzikorë të bërë me materiale të riciklueshme

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Më poshtë është një këngë. Muzikën gjejeni vetë.

Shi, shi, baba shi,
Bjer, bjer- o me furi,
shi, shi, baba-shi
jepi tokës pak freski!

Shi, shi, baba-shi
Ku ke qenë gjer tani?

Ajri



Tema: Ajri

Aktiviteti # : Një

Aktiviteti: Të vizatojmë ndotësit e ajrit

Materialet: Laps, gomë, lapsa me njgyra, shënjues

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Hidhni sytë përreth. A ju vijnë në mendje gjëra që prishin dhe ndotin ajrin? Vizatojini në kutitë e mëposhtme dhe shkruani emrin e tyre.

Tema: Ajri

Aktiviteti # : Dy

Aktiviteti : Cfarë e ndot ajrin në mjedisin rreth shkollës - Anketë

Materialet: Laps, letër, tabakë letre, shënjes, lapsa me ngjyra të ndryshme

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

E mbani mend si i bëjmë anketat? Pyesni fqinjët cilat gjëra e ndotin ajrin dhe e bëjnë atë të keq për mushkритë tona? Sillni ndër mend ndotës të ndryshëm dhe pyetini njerëzit dhe cili prej tyre ndot më shumë. Pas anketimit, merrni një tabak letre dhe shkruani përfundimet.

Ndotësit	Ky e ndot ajrin	Ky nuk e ndot ajrin
Tymi i makinave		
Cigaret		

Tema: Ajri

Aktiviteti # : Tre

Aktiviteti: Të bëjmë zile që tunden nga era

Materialet : Gërshërë, kapakë plastikë transparente, thika që presin mirë, filispango,shkopinj ose shufra, zile që tunden, hapëse vrimash.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Hapat që do të bëni

1. Prisni buzët e kthyer të kapakëve, pastaj ndihmoni fëmijët të presin shtatë (ose sa të doni) forma gjethesh nga kapakët plastikë. Nëse doni, mund të bëni "damarët" e gjetheve duke përdorur një shënjes me majë të hollë.
2. Hapni nga një vrimë në majë dhe në fund të secilës gjethe. Lidhni secilën gjethe në majë me një filispango prej 20 cm dhe më pas varini në shkopinj apo shufrën që keni gjetur në distanca të barazlarguara.
3. Me filispango të shkurtër lidhni një zile në anën e poshtme të çdo gjetheje.
4. Për ta varur, në të dy anët e shkopit apo shufrës, lidhni nga një spango të shkurtër.

Tema: Ajri

Aktiviteti # : Pesë

Aktiviteti: Të shohim ç'fluturon bashkë me erën

Materialet: Disa kapakë plastikë, zift, lente zmadhuese, hapëse vrimash - në një ditë me erë

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Ç'FLUTURON NË ERË?

PROÇESI:

Hapni një vrimë në një vend në fund të kapakut.

Kaloni një fije në vrimë dhe lidhni fundet e fijes duke krijuar një rreth për ta varur kapakun.

Lyejeni njërën anë të kapakut me zift.

Nxirrini kapakët jashtë kur të jetë ditë me erë dhe varini në vende të ndryshme.

Mbas një ore, merrini dhe shikoni se çfarë kanë mbledhur.

SHPJEGIM:

Disa nga gjërat që mund të jenë ngjitur në kapakë janë insekte, farëra, gjethe, pislleqe të ndryshme. Përdorni lentet për të zmadhuar dhe për të parë edhe gjërat e vogla që nuk duken me sy.

TOKA



Tema: Toka

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Katër stinët


Materialet: Ngjyra dhe lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Pema e mollës gjate stineve te vitit

Emri _____

Ngjyrosni pemët e mollës në këtë pikturë. Sipër çdo peme shkruani stinën: pranverë, verë, vjeshtë, dimër



Tema: Toka

Aktiviteti # : Dy


Aktiviteti: Të bëjmë një tabelë për motin në ditë të ndryshme të javës.

Materialet: Shnënjues, lapustila me ngjyra, letër, vizore, shirit ngjitës, etj

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Udhëzime

1. Merrni një tabak letre 25cm me 40 cm. Shkruani emrin tuaj dhe titullin: Tabela e Motit. Nënvizoni titullin.
2. Me vizore, bëni pesë kolona të barabarta.
3. Në krye të secilës kolonë, shkruani ditët e javës nga e hëna në të premte. Nënvizojini dhe këto.
4. Për çdo ditë të javës, flisni me shokët për motin. Sa është temperatura? A ka erë? Po shi? Apo është diell? Përdorni fjalë dhe figura për të shënuar dukuritë atmosferike.



Ditët e javës	Moti sot
E hënë	(Bëni një vizatim të dukurisë atmosferike)
E martë	
E mërkurë	

Tema: Toka

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Si duken yjet natën?

Materialet: Tabakë letre bardh e zi, gërshërë, ngjitëse, laps

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

E keni parë qiellin natën? Çfarë keni parë? Çfarë ndodh nëse pamja juaj zihet nga smogu dhe ndotja? Çfarë nuk do të arrini të shihni? Le të bëjmë bashkë një aktivitet si duket qielli natën..

- 1- Mbi një tapak letre, mundësisht letër e fortë, do të bëjmë qiellin e natës. Yjet mund t'i vizatojmë vetë ose do t'i presim nga revistat e do t'i ngjisim, ose ca do t'i bëjmë vetë e ca do t'i ngjisim. Do të përdorim ngjyra të bardha, të verdha, argjendi ose floriri për të bërë yjet.
- 2- Do të bëjmë hënën duke vizatuar një rreth të bardhë. Nëse letra e madhe mbi të cilën do punojmë është e zezë, e ngjyrosim rrethin me ngjyrë të bardhë ose floriri për të bërë hënën e plotë.
- 3- Hënën do ta ndjamë në 6 pjesë. Në fillim e ndajmë përgjysëm dhe më pas secilën gjysëm në tre pjesë. Vendosuni numra pjesëve nga mbrapa për të mbajtur mend rradhën e vendosjes së tyre. Mos harroni se çdo gjysëm hënë do shtatë ditë që të bëhet. Për të pasur hënë të plotë duhen dy javë. Secila pjesë tregon një fazë të procesit të krijimit të hënës.
- 4- Në çdo ditë të muajit shikoni hënën. Në çdo 2-3 ditë kur ajo rritet, ju do të shtoni nga një copëz. Bëjeni këtë deri në fund të muajit. Mos harroni se në gjysmën e dytë të muajit do t'ju duhet të hiqni nga një copë. Hiqni pjesë pas pjese çdo 2-3 ditë. Deri në fund të muajit nuk do të ketë më hënë .

Tema: Toka

Aktiviteti # : Katër

Aktiviteti: Të mbjellim një pemë apo një bimë

Materialet: bimë, farëra, dhe, ujë, mbajtëse për bimën, letër për zbukurimin e enës së bimës, gërshërë, letër të ricikluar.

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Një mënyrë për të treguar respekt për botën dhe bukurinë e saj është të mbjellim një pemë. Pemët thithin dioksidin e karbonit që gjendet në ajër duke e pastruar atë. Pemët janë të bukura dhe na japin hije e freski në ditë me vapë.

Vendosni objektivat.

Vendosni çfarë doni të mbillni dhe pse.

Si bëhet mbjellja

- Gjeni një enë plastike ose alumini që është për t'u hedhur.
- Pastrojeni për ta bërë gati për mbjellje.
- Mund ta mbuloni me letër për ta zbukuruar. Prisni aq letër sa duhet për ta mbuluar enën.
- Pastaj vizatoni ç'të doni në letër dhe ngjyrosni vizatimet që keni bërë. Ose prisni figura nga ndonjë revistë dhe ngjitini në letrën mbështjellëse.
- Mbështilleni enën me letrën.
- Mbusheni enën me dhe dhe hidhni pak ujë.
- Merrni bimën apo farat dhe mbulojini mirë me dhe.
- Tani vendoseni enën në një vend me diell dhe prisni që ajo të rritet.
- Mos harroni ta vadisni një herë në javë.

Tema: Toka

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të bëjmë një botë të lëvizshme

Materialet: Letër, spango, pjata letre, sende me peshë të lehtë që mund t'i lidhim rreth botës si gjethe, etj

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Çfarë do të bëjmë:

Si fillim, prisni spangon në copa me gjatësi nga 8 deri në 10 cm.

Më pas, lidhni me spango sendet e gjetura në mjedis (me peshë të lehtë).

Më pas hapni vrima në pjatat e letrës, kaloni copat e spangos dhe lidhni një në një në njërën anë.

Së fundi, lidhni fije spangoje mbi një pjatë.

Sipas dëshirës: zbukurojeni pjatën e letrës me vizatime, lapsa, letra me ngjyra, lule, etj.

Tema: Toka

Aktiviteti #: Gjashtë

Aktiviteti: Festa e stinëve

Materialet: Lapsa me ngjyra, lapsa plumbi, shënjesa

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

Shkruani emrat e stinëve në kutitë më poshtë dhe vizatoni festat që kemi në çdo stinë, si dhe rrobat që veshim në atë stinë.

NATYRA



Tema: Natyra

Aktiviteti # : Një

Aktiviteti: Të shohim fara bimësh dhe t'i vizatojmë ato.

Materiale: Lapsa, fruta dhe perime, thikë (mbajeni me kujdes).

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Zgjidhni tre fruta dhe tre perime që kanë fara. Në kolonën djathtas vizatoni frutin/perimen dhe shkruani emrat poshtë tyre. Në kolonën majtas, vizatoni farat. Kur të duhet të hapni frutin apo perimen për të parë farat, kujdes mos priteni me thikën.

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Ecje zbathur

Materialet: -

Hapi Fëmija për Fëmijën: Të kuptuarit

Një mënyrë e mirë për t'i nxitur njerëzit të ndiejnë natyrën është t'i çosh ata të ecin me këmbë zbathur. Është mahnitëse tek i sheh njerëzit të ecin zbathur dhe vëmendjen që ata kanë, se ku i vendosin këmbët e tyre. Ecja zbathur është dhe një mënyrë e mirë për të njohur kafshët e egra se si hyjnë në botën e tyre të qetë dhe të rezervuar.

Hiqni këpucët dhe çorapet. Pastaj filloni ecjen shumë ngadalë në mënyrë që të ndihet çdo gjë që shkel. Duke ecur ngadalë ju do të kenë mundësi të shihni dhe kafshët përreth.

(Sigurohuni të kontrolloni zonën për xhama, gjemba, dhe zhavorr të mprehtë).



Tema: Natyra



Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Të mësojmë cfarë hanë gjallesat e botës

Materialet: Laps, letër, gomë, lapsa me ngjyra

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

A mbani mend ç'ishte zinxhiri i ushqimit? Në zinxhirin e ushqimit, një gjallesë ha një tjetër për të jetuar. Në këto figura, lidhni me shigjeta ushqimin me atë që e ha. Kokën e shigjetës drejtojeni nga ngrënësi. Më pas, bëni një zinxhir tuajin dhe ngjyroseni.



Zinxhiri im i ushqimit

Tema: Natyra

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Të ruajmë natyrën nëpërmjet riciklimit

Materiale: Lapsa, lapsa me ngjyra

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Këtu kemi një kosh për sende të riciklueshme. Thoni disa gjëra që mund t'i vendosim këtu për t'i ricikluar. Vizatojini këto sende.



Tema: Natyra

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Kolazh me foto të natyrës

Materialet: Revista dhe gazeta që janë për t'u hedhur, ngjitës, gërshërë, letër vizatimi

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje

A e dini se ç'është kolazhi?

Është një vizatim me pamje të ndryshme të vëna bashkë në një vend.

Le të bëjmë së bashku një kolazh me pamje nga natyra.

Shfletoni revistat dhe gazetatat.

Gjeni pamje nga natyra.

Pritini këto pamje.

Në letrën e vizatimit, vendosini figurat si të shkojnë më mirë.

Lyejini pikturat nga poshtë me ngjitës dhe ngjitini në letër.

Shkruani emrin tuaj përfund.

Ju lumtë!

Merreni kolazhin me vete në shtëpi dhe diskutoni me njerëzit e shtëpisë për natyrën.

NDOTJA



Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Një

Aktiviteti: Të shohim si ndryshojnë pamje objektet për shkak të ndotjes

Materiale: Lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Të kuptuarit

Shikoni pamjet në vijim. Çfarë ndodh në këto piktura? Ç'është ajo gjëja e zezë? Nga vjen? Pse qajnë peshqit? Pse është i acaruar ai burri? Si na dëmton ndotja neve të gjithëve? A mund të vizatoni të tjera pamje dhe të shkruani nga një fjali për dëmin që sjell ndotja në jetën tonë?



Tema: Ndotja


Aktiviteti #: Dy

Aktiviteti: Anketë për ndotjen pamore dhe ndotjen nga zhurmat

Materiale: Lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve

Zhurmë, zhurmë, zhurmë! A mund të thoni disa sende që bëjnë zhurmë të madhe dhe që janë rrotull nesh? Është fjala për zhurma që na bezdisin. A mund të pikturoni disa nga këto gjëra?



Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Tre

Aktiviteti: Një vend në det

Materialet: lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Zbulimi i fakteve



Shikoni pikturën më lart. Çfarë shihni? Përshkruani pamjen me disa fjali. Përqëndrohuni tek ndotja. A ju duket e bukur kjo pamje? Si janë plazhet në Shqipëri? Nuk duhet të lejojmë të bëhen kështu.

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Katër

Aktiviteti: Të lidhim ndotjen me ndotësin

Materiale: Tabakë letre, lapsa

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

Bëni një poster që tregon se ndotja është e dëmshme për mjedisin. Mund të zgjidhni njërën nga llojet e ndotjes dhe të vizatoni ndotësin që e shkakton. Në poster mund të shkruani që të mos ndotim mjedisin. Tregojuani posterin shokëve dhe njerëzve të shtëpisë. Çfarë thonë ata për ndotjen?

Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Pesë

Aktiviteti: Të përdorim qeset plastike që kemi në shtëpi

Materiale: qese plastike

Hapi fëmijë-fëmijë: Planifikimi dhe realizimi

A keni qese plastike në shtëpi?

Si mblidhen ato?

Çfarë bëni me qeset plastike pasi ktheheni nga dyqani?

Numëroni qeset plastike që keni në shtëpi.

Mbani shënim numrin e qeseve që mblidhen në shtëpi brenda një jave.

Bëni një tabelë ku të shënoni qeset që mblidhen në një javë dhe po të doni edhe në një muaj. A mund t'i ripërdorim këto qese?

Flisni me nënën dhe babanë sesi mund të ripërdoren qeset plastike që keni në shtëpi.


Tema: Ndotja

Aktiviteti #: Gjashtë

Aktiviteti: Kopështi i fluturave

Materialet: Lule shumëngjyrëshe si lulëkuqe, vjollca, zambakë, trëndafila dhe të tjera me ngjyra të forta.

Hapi fëmijë-fëmijë: Përsëritje



Ndotja e ajrit iu bën keq edhe fluturave. Atyre iu pëlqen të shkojnë lule më lule për të mbledhur nektar. Bimët dhe lulet që duan ato nuk rriten në çdo vend për shkak se ajri është i ndotur. Por ju mund të mbillni lulet që iu pëlqejnë atyre në shtëpi! Për ta bërë këtë, më parë duhet të merrni lejen e të rriturve. Ata duhet t'ju ndihmojnë në këtë punë.

Udhëzime: (1) Zgjidhni hapësirë të madhe për këto lule sepse shpesh ato janë të mëdha; (2) sigurohuni që vendi që keni zgjedhur të ketë dritë të mjaftueshme sepse shumë prej tyre duan dritë dielli nga 6-8 orë në ditë; (3) bimët e larta mbillen mbrapa dhe bimët e ulëta përpara; (4) ujitini shpesh dhe shikoni kur do të vijnë fluturat.

MBESHTETUR NGA:

UNICEF ALBANIA



THE CHILD TO CHILD TRUST



AMBASADA E MBRETERISE HOLLANDEZE



MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCES
INSTITUTI I KURRIKULES DHE TRAINIMIT



MINISTRIA E MJEDISIT, PYJEVE DHE
ADMINISTRIMIT TE UJERAVE